

URDHËR
Nr. 4, datë 14.1.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2007, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile, z. Spiro Maliqi, për ndjekjen, trajtimin dhe nënshkrimin e praktikave të mëposhtme, për:

a) kërkesa të institucioneve publike dhe jopublike, organe të gjyqësorit dhe entiteteve të tjera, lidhur me kërkimin e informacionit, verifikimin e të dhënave të shtetasve që administrohen nga shërbimi i gjendjes civile;

b) kërkesa të shtetasve, përfaqësuesve ligjorë lidhur me problematika të ndeshura në plotësim të nevojave të tyre administrative në ofrimin e shërbimit të gjendjes civile;

c) komunikim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për çështjet zgjedhore;

ç) komunikim me kryetarët e bashkive dhe prefektët e qarqeve, lidhur me funksionimin e shërbimit të gjendjes civile;

d) komunikim me institucione të tjera shtetërore dhe organizma ndërkombëtarë që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për çështje nën fushën e përgjegjësisë së gjendjes civile, duke përfshirë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj.;

dh) komunikim me shoqërinë “Identitek” sh.a. dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për çështje të pajisjes së shtetasve me dokumente biometrike.

2. Delegimin e vulës drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile për praktikat e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Kompetencat, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 15.1.2025 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Gjendjes Civile.

5. Urdhri nr. 171, datë 13.9.2024, i ministrit të Brendshëm, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha